

Siguri

Armatim dhe qindra fishekë zbulohen në një shtëpi të pabanuar në Zubin Potok



Sinjali.com

09 Korrik 2026 14:07



Policia e Kosovës ka sekuestruar një sasi të konsiderueshme armësh dhe municioni gjatë një operacioni të zhvilluar në fshatin Lucka Reka, në komunën e Zubin Potokut, pas informacioneve të siguruara nga qytetarët.

Sipas Policisë, aksioni u ndërmor pasi zyrtarët policorë morën njoftime se në një shtëpi të pabanuar mund të fshiheshin armë dhe mjete të tjera ilegale. Pas kontrollit të objektit, u gjetën një armë e gjatë gjysmëautomatike, qindra fishekë të kalibrave të ndryshëm, gëzhoja dhe një bajonetë.

Në mesin e materialeve të sekuestruara janë 392 fishekë të kalibrit 7.62 mm, 123 fishekë të kalibrit 7.9 mm, fishekë për armë gjahu dhe armë të gjata, si dhe municion për armë të shkurtra.

Lidhur me rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit, i cili ka urdhëruar iniciimin e procedurës për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Policia bëri të ditur se deri më tani nuk ka persona të arrestuar, ndërsa hetimet janë duke vazhduar për identifikimin e personave përgjegjës dhe zbardhjen e plotë të rastit.

Autoritetet kanë falënderuar qytetarët për bashkëpunimin dhe kanë bërë thirrje që çdo informacion që lidhet me armë ilegale apo veprimtari të dyshimta të raportohet tek organet e rendit.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera